

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALEKSI INERTE" Sh.P.K
STATUTI

I
NENI 1
EMRI

Sot me datë 15.11.2024 Shoqëria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet
"ALEKSI INERTE" Sh.P.K
e cila ketu e me poshte do te quhet shoqëria. Ajo krijohet nga ortaket themelues:
Z. ALEKSANDER GJOKA, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për
të vepruar, i datëlindjes 26.03.1978, lindur në Kashnjet dhe banues në Tiranë,
identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. personal **H80326086F**

NENI 2
FORMA

Forma ligjore: **Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar.**

NENI 3
BAZA JURIDIKE

Shoqëria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne përputhje me kete legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqërise do te jete ne **Tirane Kamez BATHORE Lagjia Nr. 5, Rruga Bilisht, Banesa Nr. 3**, dhe mund te ndryshoje adresen e selise se saj vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 5
TERRITORI

Shoqëria e zhvillon aktivitetin ne territorin e Republikes se Shqipërisë si dhe jashtë saj. Shoqëria mund te krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne përputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.


NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqërise do te jete:

Grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte dhe mbetjeve të parrezikshme. Aktivitet ndërtimi, transporti, mallrash e udhëtaresh për vete dhe të tretë ,shërbime për grumbullime, përpunime inertesh, përpunimi i tyre në gurore tregtim lëndve për guroren,tregim i materialeve të ndërtimit, inerteve të ndryshme, shfrytëzim mineralesh etj.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqërise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqëria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organet kompetente.

NENI 7
KOHEZGJATJA



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara me ligj ose me vendim të Asamblese së Ortakeve.

NENI 8
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100 000 leke (njëqind mijë leke). Ky kapital është teresisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët. Shoqëria mund të shtojë ose të zvogelojë kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të asamblese së ortakeve.

NENI 9
KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Ortaku i Shoqërisë **Z. ALEKSANDER GJOKA**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 26.03.1978, lindur në Kashnjet dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. personal **H80326086F**

NENI 10
PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë prej 1 (një) kuote, plotësisht të shlyera, me vlerë nominale 100.000 leke (njëqind mijë leke).

NENI 11
ADMINISTRIMI

Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga administratori. Administrator i shoqërisë është **Z. ALEKSANDER GJOKA**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 26.03.1978, lindur në Kashnjet dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. personal **H80326086F**

Ai e ushtrojnë këto detyra për një periudhë 5 vjeçare.

NENI 12
DISPOZITA TË FUNDIT

Shoqëria do të rregullohet përveç nëpërmjet këtij Akti Themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortakët dhe si i tillë do të miratohet në Qendren Kombëtare të Biznesit ditën e legalizimit si Person Juridik në Shqipëri.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (kater) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtte ligjore.

THEMELUESIT

ALEKSANDER GJOKA
Emer, Mbiemer, Firme

